



RAPORTI I MBIKËQYRJES | **2019**
SUPERVISION REPORT

TREGU I SIGURIMEVE, I FONDEVE TË PENSIONEVE VULLNETARE, I FONDEVE TË INVESTIMEVE
INSURANCE, VOLUNTARY PENSIONS FUNDS, INVESTMENTS FUNDS MARKET

PËRMBAJTJA

I.	Misioni i Mbikëqyrjes	5
II.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve	6
	1. Struktura e Tregut të Sigurimeve	6
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	6
	3. Analiza e Ecurisë dhe Rreziqeve të Tregut të Sigurimeve	9
III.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	12
	1. Struktura e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	12
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	13
	3. Treguesit Teknikë e Financiarë të Tregut të Fondeve të Pensioneve Vullnetare	14
IV.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Investimeve	15
	1. Struktura e Tregut të Fondeve të Investimeve	15
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Investimeve	16
	3. Treguesit Kryesorë të Tregut të Fondeve të Investimeve	16
V.	Tregu i Kapitaleve	18
	1. Tregu i obligacioneve të shoqërive aksionare (Obligacionet e emetuara me ofertë private)	18
	2. Tregu i rregulluar	19
	3. Mbikëqyrja e tregut të kapitaleve	20
	4. Zhvillime në përmirësimin e infrastrukturës së tregut	22
VI.	Anekse	23
	A. Tregu i Sigurimeve, 31.12.2019	23
	B. Tregu i fondeve të pensioneve private vullnetare, 31.12.2019	85
	C. Tregu i Fondeve të Investimeve, 31.12.2019	93
	D. Shoqëritë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	110





TABLE OF CONTENTS

I.	Supervision Mission	5
II.	Report on the Financial Position of the Insurance Market	6
	1. Insurance Market Structure	6
	2. Insurance Market Supervision	6
	3. Analysis of Insurance Market Performance and Risks	9
III.	Report on the Financial Position of the Voluntary Private Pension Market	12
	1. Voluntary Private Pensions Market Structure	12
	2. Voluntary Private Pension Market Supervision	13
	3. Technical and Financial Indicators on the Voluntary Pension Funds	14
IV.	Report on the Financial Position of the Investment Fund Market	15
	1. Investment Funds Market Structure	15
	2. Investment Funds Market Supervision	16
	3. Key Indicators of the Investment Funds Market	16
V.	Capital Market	18
	1. Corporate Bonds Market (Bonds Issued via Private Placements)	18
	2. Regulated Market	19
	3. Capital Market Supervision	20
	4. Market Infrastructure Improvements	22
VI.	Annexes	23
	A. Insurance Market, 31.12.2019	23
	B. Voluntary Private Pension Funds Market, 31.12.2019	85
	C. Investment Funds Market, 31.12.2019	93
	D. Pension Funds' and Collective Investment Undertakings' Management Companies	110



I. Misioni i Mbikëqyrjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është autoritet mbikëqyrës dhe rregullator i integruar i tregut financiar të sigurimeve, të letrave me vlerë dhe të pensioneve private vullnetare në Shqipëri. AMF i ushtron funksionet mbikëqyrëse mbështetur në Ligjin nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar me Ligjin nr. 54/2014.

Misioni themelor i AMF-së, si autoritet mbikëqyrës është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore në fuqi.

AMF do të vijojë realizimin e misionin mbikëqyrës, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane, bashkërendimit të analizës së dokumentacionit financiar dhe mbikëqyrjes në vend të tregut, orientimit të procesit të mbikëqyrjes drejt mbikëqyrjes me fokus rreziku, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, si edhe trajnimit të burimeve njerëzore drejt një mbikëqyrjeje efektive.

I. Supervision Mission

The Financial Supervision Authority (AFSA), is the supervisory authority and integrated regulator of the financial insurance market, securities and voluntary private pensions, in Albania. AFSA conducts its supervisory functions pursuant to Law No. 9572, dated 03.07.2006, “On the Financial Supervisory Authority”, as amended by Law No. 54/2014.

AFSA’s basic mission, as a supervisory authority, is to ensure the protection of the best interest of consumers and investors, closely linked to the safety of the supervised operators, by ensuring compliance with the applicable legal provisions.

AFSA shall continue carrying out its supervisory mission through continuous improvement of the supervisory regulatory framework, in accordance with international principles and European directives; coordination of financial documentation analysis and on-site market supervision; orientation of the supervisory process towards a risk-based supervision and undertaking of the market development policies, as well as training of human resources towards an effective supervision.

II. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve

1. Struktura e tregut të sigurimeve

Në fund të vitit 2019, në tregun e sigurimeve ushtronin veprimtarinë e tyre 12 shoqëri sigurimi Jetë dhe Jo-Jetë. Në strukturën e tregut, tetë shoqëri sigurimesh ushtrorjnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jo-Jetës dhe katër në sigurimet e Jetës. Një nga shoqëritë e Jo-Jetës kryen gjithashtu edhe aktivitetin e risigurimit. Bazuar në pasqyrën e llogarisë teknike të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, edhe gjatë këtij viti vihet re se tregu i sigurimeve vazhdon të dominohet nga produktet e sigurimeve të detyrueshme dhe në veçanti nga portofoli i MTPL-së së brendshme.

2. Mbikëqyrja e tregut të sigurimeve

Tregu i sigurimeve, gjatë vitit 2019, vijoi zgjerimin me një ritëm relativisht të qëndrueshëm, me total aktivesh që luhet në intervalin 1.9-2.3% të Prodhimit të Brendshëm Bruto¹ (PBB) për periudhën 2015-2019. Zgjerimi ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së vëllimit të primeve të shkruara bruto, kryesisht në produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Peshat e tregut të sigurimeve, në tregjet financiare që mbikëqyren nga AMF, paraqitet në rritje vitet e fundit, përkatësisht 30.6%, 31.6% dhe 38.8% për vitet 2017-2019. AMF, si autoritet mbikëqyrës e rregullator për tregun e sigurimeve ka si objektivi, ndër të tjera, nxitjen dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të tregjeve nën mbikëqyrje. Si rrjedhojë paraqitet nevoja për:

- Ushtrimin e një mbikëqyrje efektive dhe nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm të tregut të sigurimeve;
- Plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator.

Ruajtja dhe nxitja më tej e qëndrueshmërisë financiare do të arrihet nëpërmjet vijimit të zbatimit të mbikëqyrjes me bazë rreziku, forcimit të rregullave të administrimit të rrezikut dhe në harmoni me direktivat përkatëse të BE-së e bazën ligjore në fuqi.

Gjatë vitit 2019, tregu shqiptar i sigurimeve pati një rritje të vëllimit total të primeve të shkruara bruto, të cilat kapën shifrën 17.6 miliardë lekë, duke u rritur afërsisht me 4.1% krahasuar me vitin 2018.

Në strukturë, tregu vijoi të mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat zënë rreth 93.1% të vëllimit

¹ Të dhënat për Prodhimin e Brendshëm Bruto janë marrë nga faqja online e Institutit të Statistikave. 2018* PBB, Gjysëm-finale 2019* GDP Paraprake <http://www.instat.gov.al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-komb%C3%ABtare-gdp/>

II. Report on the Financial Position of the Insurance Market

1. Insurance market structure

By the end of 2019, 12 Life and Non-Life insurance companies operated in the insurance market. In the market structure, eight and four insurance companies operate in the Non-Life and Life market respectively. One of the Non-Life insurance companies also carries out reinsurance activities. Based on the technical account statement of Non-Life insurance companies, the 2019 insurance market continues to be dominated by compulsory insurance products, especially the internal MTPL portfolio.

2. Insurance market supervision

During 2019, the insurance market continued its expansion at a relatively stable pace, with total assets fluctuating between 1.9-2.3% of the Gross Domestic Product (GDP)¹ for the period 2015-2019. This expansion is due to an increase in the gross written premiums volume, mainly in compulsory motor insurance products. The insurance market share in the financial markets supervised by AFSA, displays increasing trends: 30.6%, 31.6% and 38.8% for the years 2017-2019 respectively. AFSA, as the supervisory and regulatory authority for the insurance market, has, as one of its objective, the promotion and maintenance of the financial stability of the supervised markets. Consequently:


- Exercising effective supervision and promoting further development of the insurance market;
- Legal and regulatory framework completion and improvement;

The maintenance and further promotion of the financial sustainability shall be achieved through the continued implementation of risk-based supervision, strengthening risk management rules in line with relevant EU directives and the applicable laws.

During 2019, the Albanian insurance market experienced a growth in the total volume of gross written premiums, which reached ALL 17.6 billion, increasing by approximately 4.1% compared to 2018.

With regard to its structure, the market continued to be oriented towards Non-Life insurance, which accounts for

¹ All data on GDP are taken from INSTAT website. 2018* GDP, Semi-final. 2019* GDP, Preliminary. <http://www.instat.gov.al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-komb%C3%ABtare-gdp/>



të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg². Ndërsa sigurimet e Jetës, zënë 6.9% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Gjatë vitit 2019, sigurimet vullnetare përbëjnë 36%, ndërsa ato të detyrueshme 64% të totalit të primeve të shkruara bruto. Edhe gjatë vitit 2019, AMF ka mbikëqyrur dhe analizuar tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit.

AMF ka vijuar zbatimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun, që synon hartimin e një profili rreziku për shoqërinë e sigurimit. Ky profil rreziku përfaqëson vlerësimin nga ana e autoritetit mbikëqyrës në lidhje me fushat e rreziqeve specifike të shoqërisë, brenda kontekstit të sektorit të sigurimeve. Pjesë e kësaj metodologjie janë dhe fazat e ndërhyrjes nga ana e autoritetit mbikëqyrës, gjatë niveleve të ndryshme të rrezikut, ndërhyrje e cila ndryshon në varësi të nivelit të rrezikut për cilëndo nga shoqëritë e sigurimit.

Autoriteti, në vitin 2019, filloi ciklin e dytë të inspektimeve sipas metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun për tregun e sigurimeve. Në përfundim të inspektimeve, Autoriteti përditësoi profilin e rrezikut për shoqëritë e inspektuara, i cili përfaqëson vlerësimin për secilin nga rreziqet e shoqërisë së sigurimeve. Ky profil shërben si bazë për vendosjen e prioriteteve mbikëqyrëse dhe shpërndarjen e kapaciteteve të duhura sipas nivelit të ekspozimit të rrezikut.

Gjatë vitit 2019 janë kryer disa inspektime të përbashkëta me institucione të tjera me të cilat Autoriteti bashkëpunon me qëllim një mbikëqyrje të plotë dhe efektive të tregut të sigurimeve. Autoriteti ka kryer për herë të parë një inspektim me Autoritetin Austriak të Tregjeve, i zhvilluar në Austri dhe Shqipëri me një grup inspektimi të përbërë me përfaqësues nga dy institucionet. Inspektime janë kryer në bashkëpunim edhe me Bankën e Shqipërisë, pranë të gjitha bankave tregtare, me objekt verifikimin në vend të produkteve bankare aktive të shoqërive të sigurimit, si dhe verifikimin e lëvizjeve të depozitave të shoqërive me bankat (depozita me afat, llogari kursimi dhe llogari rrjedhëse), për disa nga shoqëritë e sigurimit.

Si risi në punën e AMF-së gjatë vitit 2019 ishte kryerja e inspektimeve tematike në të gjitha shoqëritë që ushtrjnë aktivitetin e sigurimit në klasat e Jetës dhe të Jo-Jetës, me fokus aktivitetin e risigurimit. Ky proces inspektimesh u përqendrua kryesisht në: (i) përshtatshmërinë e kontratave dhe programit të risigurimit; (ii) verifikimin e nivelit të aprovimit të kontratave të risigurimit; (iii) mekanizmat e kontrollit të brendshëm; (iv) përvojën teknike të stafit, si

93.1% of the total volume of gross written premiums in this market². Whereas Life insurance occupy 6.9% of the gross written premiums' total volume. During 2019, voluntary and compulsory insurance occupied 36% and 64% of the total gross written premiums respectively. During 2019, AFSA has carried out the supervision and analysis of the insurance market, assessing the financial position, results and technical indicators of the insurance companies' activity.

AFSA continued implementing the risk-based supervision methodology, which aims at developing the risk profile of the insurance companies. The risk profile represents the valuation, by the supervisory authority, of the areas of specific risks for a company within the insurance sector. The intervention phases undertaken by the supervisory authority, at different risk levels, are also part of this methodology. Such phases vary, depending on the level of risk each insurance company is exposed to.

In 2019, AFSA began the second cycle of inspections according to the risk-based supervision methodology aimed at the insurance company. By the end of these inspections, AFSA updated the risk profile of the inspected companies, which represents the assessment for each of the risks the insurance companies are exposed to. This profile serves as a basis for setting supervisory priorities and allocating the appropriate capacities, according to the level of risk exposure.

During 2019, several joint inspections were carried out in tandem with other institutions which AFSA cooperates with, in view of ensuring a full and effective supervision of the insurance market. AFSA has conducted for the first time a joint inspection with the Austrian Financial Market Authority (FMA) in Austria and Albania. The inspection team was composed of representatives from both authorities. Inspections were also carried out in cooperation with Bank of Albania (BoA), at all commercial banks, in view of on-site verifications of active banking products of insurance companies, as well as of transactions with deposits between insurance companies and banks (time deposits, savings accounts and current accounts), with regard to some of the insurance companies.

A novelty in the work of AFSA performed during 2019, was the conduct of thematic inspections in all companies that carry out insurance activity in the Life and Non-Life classes, focusing on the reinsurance activity. This inspection process focused mainly on: (i) suitability of contracts and reinsurance program; (ii) verifying the reinsurance contracts' level of approval; (iii) internal control mechanisms; (iv) staff technical experience, as well as other matters at the request

²Në sigurimet e Jo-Jetës është përfshirë edhe veprimtaria e risigurimit.

²Non-Life insurance includes also reinsurance activity.

dhe të tjera çështje sipas kërkesës së grupit të inspektimit. Inspektimet u zhvilluan në bazë të “Manualit Praktik për Mbikëqyrjen e Veprimtarive të Risigurimit”, miratuar me vendimin e Bordit të Autoritetit Nr. 140, datë 30.07.2018.

Siç u verifikua me ndodhjen e dy ngjarjeve të tërmetit gjatë vitit 2019, gjatë inspektimit pranë shoqërive të sigurimit u konstatua një nivel i mirë i menaxhimit të rrezikut përsa i përket këtij aktiviteti. Bazuar në vlerësimet paraprake, duke përfshirë dhe dëmet IBN(E)R (*Incurring but not (enough) reported*), vlera e kërkesave për dëmshpërblim arriti rreth 487 milionë lekë për ngjarjen e 21 shtatorit dhe rreth 3.8 miliardë lekë për ngjarjen e 26 nëntorit, deri në 31.12.2019. Referuar numrit të dëmeve të raportuara, në linjë me pronat e siguruar, vihet re, që rreth 85% e tyre i përkasin të siguruarve, të cilët kanë siguruar pronën për efekt kredie, ndërsa pjesa tjetër janë prona të siguruar në mënyrë vullnetare.

Si rezultat i menaxhimit të rrezikut, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, vlera e dëmeve që pritet të paguhet nga shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë aktivitetin në Shqipëri, për secilën nga ngjarjet, arrin deri në 220 milionë lekë, ndërsa diferenca pritet të paguhet nga shoqëritë e risigurimit. Cilësia e risiguresve kryesorë është A+ e lart sipas agjencive klasifikuese Standard & Poors, AM Best, Fitch, etj., duke qenë në zbatim të Rregullores nr. 85/1, datë 30.09.2015 “Për kriteret e risigurimit”, e ndryshuar.

Në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të grupeve zbatohet udhëzimi metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 250, datë 28.12.2018. Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar Kolegjet Mbikëqyrëse Rajonale me pjesëmarrjen e 3 rregullatorëve AMF, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ISA) i Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, gjatë vitit 2019, përfaqësues të AMF-së morën pjesë në takimet e përvitshme të kolegjeve të mbikëqyrjes të grupeve të sigurimeve UNIQA Insurance Group (UIG) dhe Vienna Insurance Group (VIG), të cilat organizohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Austrisë (FMA). Kolegjet mbikëqyrëse kanë qëllim shkëmbimin e informacionit në lidhje me ecurinë e grupeve të sigurimit, në funksion të një mbikëqyrjeje financiare sa më efektive.

3. Analiza e ecurisë së tregut të sigurimeve³

Ecuria e treguesve kryesorë financiarë të tregut të sigurimeve për vitin 2019, paraqitet si më poshtë:

- **Totali i primeve të shkruara bruto**, për tregun e sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës në 31.12.2019 është 17.6 miliardë lekë duke shënuar një rritje

³Treguesit financiarë pasqyrojnë të dhënat pas certifikimit të raporteve të audituara dhe analizës financiare të shoqërive të sigurimit.

of the inspection team. Inspections were conducted pursuant to the “Practical Manual on Supervision of Reinsurance Activities”, adopted by AFSA Board with Decision No. 140, dated 30.07.2018;

As verified during the occurrence of the two earthquake events of 2019, inspections by insurance companies revealed a good level of risk management in terms of this activity. Based on preliminary estimates, including IBN(E)R claims (Incurring but not (enough) reported), until 31.12.2019, claims amounted to ALL 487 million for the September 21 event and approximately ALL 3.8 billion for the November 26 event. Referring to the number of reported damages, in line with the insured properties, it is noted that about 85% of them belong to the insured, who have secured the property for credit purposes, while the remainder are properties insured voluntarily.

As a result of risk management, in accordance with the legal and regulatory framework in force, the value of claims expected to be paid by insurance companies operating in Albania, for each of the events, reaches up to ALL 220 million, while the difference is expected to be paid by the reinsurance companies. According to the rating agencies Standard & Poors, AM Best, Fitch, etc., the quality of the main reinsurers is A + and above, in compliance with Regulation No. 85/1, dated 30.09.2015, “On reinsurance criteria”, as amended.


In view of a more effective groups’ supervision, the methodological guidelines “On insurance groups supervision”, adopted with Board’s Decision No. 250, dated 28.12.2018, was employed. During 2019, Regional Supervisory Colleges were organised and attended by 3 regulatory bodies: the AFSA, the Central Bank of Kosovo (CBK) and the Insurance Supervision Agency of North Macedonia (ISA). Also during 2019, ASFA representatives attended the annual meetings of the insurance groups, UNIQA Insurance Group (UIG) and Vienna Insurance Group (VIG) supervisory colleges, organised by the Austrian Financial Market Authority (FMA). The supervisory colleges’ objective is to exchange information concerning insurance groups’ progress, in view of a more effective financial supervision.

3. Analysis of the insurance market performance³

The progress of the 2019 insurance market financial indicators, is as follows:

- **Total of gross written premiums for Life and Non-Life insurance market**, as of 31.12.2019, is ALL 17.6 billion, marking an increase of ALL 690 million

³Financial indicators reflect data upon certification of audited reports and the financial analysis of insurance companies.



prej 690 milionë lekë ose 4.1% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së vëllimit të primeve të shkruara bruto në masën 617 milionë lekë ose 39% për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës. Tregu i sigurimeve të Jetës, ka shënuar një rritje prej 72.4 milionë lekë ose 6.33%.

- **Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit** për tregun e Jo-Jetës në 31.12.2019 është i mjaftueshëm, me 67 milionë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 101.8%. Për tregun e Jetës treguesi është sërish i mjaftueshëm me rreth 352 milionë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 123.8%. Për tregun e sigurimeve në total, ky tregues paraqitet në nivelin 108.15%.
- **Treguesi i Aktiveve në mbulim të Provigjoneve Teknike** për tregun e sigurimeve për vitin 2019 është në masën 121.13%. Në vitin 2019 ky tregues për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës është 121.16%. Për tregun e Jetës ky tregues është 120.79%.
- **Treguesit e Rentabilitetit ROE (Kthimi nga kapitalet e veta) dhe ROA (Kthimi nga investimi)** për vitin 2019, janë përkatësisht ROE në nivelin 7.73%, nga 7.3% në vitin 2018 dhe ROA 2.4%, nga 2.37% në vitin 2018.
- **Totali i aktiveve** të tregut të sigurimit në fund të vitit 2019, sipas pasqyrave financiare, është 38.8 miliardë lekë dhe ka pësuar rritje në vlerën 7.23 miliardë lekë, ose 22.94% në krahasim me fundin e vitit 2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga sektori i Jo-Jetës si rezultat i rritjes së pjesës së risiguruesve në provigjonet teknike të dëmeve, për dëmet e shkaktuara nga dy tërmetet e ndodhura gjatë vitit 2019. Totali i aktiveve në tregun e Jetës u rrit me 778 milionë ose 23.4% më shumë krahasuar me vitin 2018. Licencimi në shtator 2019 i një shoqërie të re në tregun e Jetës ka ndikuar në rritjen e investimeve nga shoqëritë pjesëmarrëse në këtë treg.
- Gjatë vitit 2019 vihet re një rritje e zërit të **Provigjoneve Teknike Bruto**. Në nivel tregu rritja në Provigjonet Teknike Bruto është në masën 34.82% ose në vlerën 5.7 miliardë lekë krahasuar me 31.12.2018. Rritjen më të madhe e ka pasur sektori i sigurimit të Jo-Jetës me 5.47 miliardë lekë, ose 37% kryesisht e lidhur me ngjarjet e tërmetit të ndodhura gjatë vitit 2019, ndërsa sektori i sigurimit të Jetës është rritur me 174 milionë lekë, ose 10% më shumë se në vitin 2018.

or 4.1% compared to the previous year. Such increase is due to the increase of the gross written premiums volume by ALL 617 million, or 39%, in the Non-Life insurance market. The Life insurance market increased by ALL 72.4 million, or 6.33%.

- **The Capital Adequacy Indicator** for the Non-Life market, on 31.12.2019, is sufficient, with ALL 67 million, or 101.8%, above the required level. For the Life market, the indicator is also sufficient, with about ALL 352 million, or 123.8%, above the required level. With regard to total insurance market, this indicator accounts for 108.15%.
- **The Indicator of Assets covering Technical Provisions** for the insurance market for 2019 is 121.13%. In 2019, this indicator, for the Non-Life insurance market, reached to 121.16%, whereas for the Non-Life insurance market, 120.79%.
- **ROE (Return on Equity) and ROA (Return on Assets) Profitability Indicators** for 2019 are as follows: ROE 7.73%, from 7.3% in 2018 and, ROA 2.4%, from 2.37% in 2018.
- **By the end of 2019, the total assets** of the insurance market, according to the financial statements, amounted to ALL 38.8 billion, marking an increase of ALL 7.23 million or 22.94% compared to the end of 2018 period. This increase is mainly attributed to the Non-Life sector, due to the increase in the share of reinsurers in claims technical provisions for the damages caused by both the 2019 earthquakes. Total assets in the Life market increased by 778 million or 23.4%, compared to 2018. The licensing in September 2019 of a new company in the Life market, led to an increase in investments by companies therein participating.
- **During 2019, an increase in the Gross Technical Provisions** item is noticed. At market level, such increase in Gross Technical Provisions was equal to 34.82% or ALL 5.7 billion compared to 31.12.2018. The largest increase was in the Non-Life insurance sector, with ALL 5.47 billion, or 37%, mainly due to the 2019 earthquake events, whereas the Life insurance sector increased by ALL 174 million, or 10%, compared to 2018.

- **Rezultati financiar neto** i tregut të sigurimeve për vitin 2019 është pozitiv në vlerën 843 milionë lekë. Ky rezultat krahasuar me vitin 2018 ka një rritje prej 12.72%. Të dy tregjet e sigurimeve kanë pësuar rritje, konkretisht 90 milionë lekë ose 15.24% për tregun e Jo-Jetës dhe 5.4 milionë lekë ose 3.4% për tregun e Jetës. Rritja e rezultatit financiar në përqindje rezultoi më e madhe se rritja e primeve të shkruara bruto dhe kjo tregon se ndikim ka pasur ulja e shpenzimeve të shoqërive në arritjen e këtij rezultati.
- **Raporti i primeve të shkruara bruto ndaj PBB**, në masën 1.05%, tregon se tregu i sigurimeve ka nevojë për diversifikim dhe zhvillim.
- *The 2019 net financial result of the insurance market is positive, amounting to ALL 843 million. Compared to 2018, this result displays an increase of 12.72%. Both insurance markets have increased: ALL 90 million, or 15.24%, for the Non-Life market and ALL 5.4 million, or 3.4%, for the Life market. The increase in percentage of the financial result is greater than the increase in gross written premiums, indicating the result was affected by the reduction of companies' expenses.*
- *The ratio of gross written premiums to GDP, at 1.05%, shows that the insurance market needs further diversification and development.*


Edhe gjatë vitit 2019, me qëllim vlerësimin e shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, janë përdorur testet e paralajmërimit të hershëm (*Early Warning Test*). Këta tregues financiarë i shërbejnë evidentimit të problemeve që mund të bëhen shkak për përqesimin e një ose disa parametrevë të operatorëve në treg. Ruajtja e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje dhe mbrojtja e konsumatorit janë ndër objektivat kryesore të veprimtarisë së AMF-së. Veprimet e Autoritetit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve në këtë drejtim, përfshijnë monitorimin e praktikave të tregut në mënyrë të vazhdueshme dhe ndërhyrjen me theks të veçantë në ato aktivitete, të cilat janë të ekspozuara ndaj rrezikut të lartë apo që mund të sjellin cenim të interesave të konsumatorëve.

Even during 2019, in view of assessing the financial health of Non-Life insurance companies, Early Warning Tests were used. These financial indicators serve to identify issues that may cause the deterioration of one or more parameters of market operators. Maintaining the sustainability of financial markets under supervision and consumer protection, are among the main objectives of AFSA's activity. The actions of the Authority in order to prevent and eliminate violations in this regard, include: monitoring of market practices on a continuous basis and intervention, with particular emphasis on those activities, which are exposed to high risk or which may lead to infringement of consumer interests.

Gjatë vitit 2019, rekomandimet që AMF ka dhënë lidhen kryesisht me:

During 2019, the recommendations issued by AFSA are mainly related to:

- Ruajtjen dhe arritjen e aftësisë paguese të disa shoqërive, sipas dispozitave të nenit 80 të Ligjit 52/2014;
- Ruajtjen dhe arritjen e treguesit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, sipas dispozitave të nenit 96 të Ligjit 52/2014;
- Plotësimin e kërkesave të Bordit të AMF-së në lidhje me pasqyrimin e saktë në pasqyrat financiare dhe shlyerjen e detyrimeve që lidhen me dëmet e Fondit të Kompensimit;
- Administrimin e rreziqeve të kontraktuara nga shoqëritë e sigurimit në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;
- Vlerësimin dhe trajtimin e dëmeve, si edhe zbatimin e kërkesave ligjore në drejtim të provigjionimit të dëmeve në proces gjyqësor, për një pasqyrim sa më të drejtë të nivelit të rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë;
- *Attainment and preservation of the solvency capacities of some companies, as provided for in Article 80 of Law 52/2014;*
- *Achievement and preservation of the assets' indicators, covering technical provisions, as provided for in Article 96 of Law 52/2014;*
- *Fulfilment of AFSA Board's requirements regarding the accurate reflections in the financial statements and settlement of claims related to the Compensation Fund claims;*
- *Management of risks encountered by the insurance companies, in compliance with the applicable legal requirements;*
- *Claims assessment and handling, as well as compliance with the legal requirements for the provision of claims in court proceedings, for a fair reflection of the level of risk encountered by companies;*



- Ndjekjen dhe zbatimin e rregulloreve të miratuara nga Autoriteti lidhur me trajtimin dhe pagesën e dëmeve;
- Raportimin në Autoritet të informacionit të kërkuar sipas kërkesave ligjore në fuqi; etj.
- *Follow-up and implementation of regulations adopted by AFSA, regarding claims handling and payment;*
- *Reporting to AFSA the required information, in compliance with the applicable legal requirements; etc.*

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Fondi i Garancisë është investuar në “depozita qëllimore” në bankat tregtare dhe letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

AFSA has monitored on a continuous basis the fulfilment of the legal requirement on the guarantee fund of insurance companies and the implementation of its investment rules. The Guarantee Fund is invested in “specific-purpose deposits” in commercial banks and securities issued by the Bank of Albania, in compliance with the legal requirements in force.

III. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Pensioneve Private Vullnetare

1. Struktura e tregut pensioneve private vullnetare

Në tregun e pensioneve private vullnetare gjatë vitit 2019 kanë operuar tre fonde pensioni, të administruara nga tri shoqëri të ndryshme administrimi.

- Shoqëria administruese e fondeve të pensionit dhe SIK Raiffeisen Invest sh.a. administron një fond pensioni i cili është Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 107, datë 18.10.2010 dhe tre fonde investimi, të cilët janë Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 180, datë 13.12.2011, Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 135, datë 26.09.2012 dhe Fondi i Investimit Raiffeisen Vizion miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 143, datë 30.07.2018.

Për këtë shoqëri, funksionin e depozitarit e kryen Banka e Parë e Investimeve, e cila është licencuar nga AMF për të kryer funksionin e depozitarit me Vendim Bordi nr. 80, datë 30.08.2010 miratuar me Vendim Bordi të AMF Nr. 143, datë 30.07.2018.

- Shoqëria administruese e fondeve të pensionit Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a. është licencuar si e tillë me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 50, datë 30.03.2011. Ajo aktualisht administron vetëm një fond pensioni i cili është Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 51, datë 30.03.2011.

Për këtë shoqëri, funksionin e depozitarit e kryen Banka Amerikane e Investimeve sh.a, e cila është licencuar nga AMF për të kryer funksionin e depozitarit me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 5 datë 03.07.2017.

- Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit dhe SIK "Credins Invest" sh.a. është licencuar fillimisht si shoqëri administruese e fondeve të pensionit e njohur nën emrin "SiCRED" sh.a. me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 156, datë 23.11.2011. Nëpërmjet Vendimit të Bordit të AMF-së nr. 85, datë 30.05.2016 u miratua licencimi i kësaj shoqërie për të kryer edhe veprimtari administrimi të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive nën emrin e ri "Credins Invest" sh.a.

Kjo shoqëri aktualisht administron fondin e pensionit vullnetar "Sicred Pensions", miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 173, datë 13.12.2011 dhe fondin e

III. Report on the Financial Position of the Voluntary Private Pension Market

1. Voluntary private pensions market structure

During 2019, three pension funds, managed by three different management companies, operated in the voluntary private pension market.

- The pension funds management company and CIU Raiffeisen Invest sh.a., manage Raiffeisen Voluntary Pension Fund, as approved by AFSA Board Decision No. 107, dated 18.10.2010, three investment funds, part of Raiffeisen Prestige Investment Fund, as approved by AFSA Board Decision No. 180, dated 13.12.2011, Raiffeisen Invest Euro Investment Fund, adopted by AFSA Board Decision with No. 135, dated 26.09.2012, and Raiffeisen Vision Investment Fund, adopted by the AFSA Board Decision with No. 143, dated 30.07.2018.

For this company, the depository function is performed by the First Investment Bank, which is licensed by AFSA to perform depository functions by Board Decision No. 80, dated 30.08.2010, approved by AFSA Board Decision No. 143, dated 30.07.2018.

- Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a pension fund management company is licensed as such by AFSA Board Decision No. 50, dated 30.03.2011. It currently manages only one pension fund which is the Sigal Voluntary Pension Fund, approved by AFSA Board Decision No. 51, dated 30.03.2011.

For this company, the depository function is performed by Tirana Bank, which is licensed by AFSA to perform the function of the depository by Board Decision No. 5, dated 03.07.2017.

- The Pension Fund Management Company and CIU "Credins Invest" sh.a. was initially licensed as a pension fund management company, known as "SiCRED" sh.a., by AFSA Board Decision no. 156, dated 23.11.2011. Through AFSA Board Decision No. 85, dated 30.05.2016, the licensing of this company was approved to perform asset management activities of collective investment undertakings under the new name "Credins Invest" sh.a.

Currently, this company manages the voluntary pension fund "Sicred Pensions", approved by the AFSA Board Decision No. 173, dated 13.12.2011, and the "Credins



investimit “Credins Premium”, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 86, datë 30.05.2016. Për këtë shoqëri, funksionin e depozitarit e kryejnë Tirana Bank dhe Banka e Parë e Investimeve⁴.

2. Mbikëqyrja e tregut të pensioneve private vullnetare

Mbikëqyrja e tregut të pensioneve private vullnetare ushtrohet nga AMF mbështetur në Ligjin 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, ndryshuar me Ligjin 54/2014, si dhe Ligjin 10197 datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Qëllimi i ligjit për fondet e pensionit vullnetar është të vendosë standardet e nevojshme për:

- Administrimin me efektivitet të fondeve të pensionit vullnetar, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e kontributeve të bëra në fondin e pensionit;
- Mbikëqyrjen e biznesit të fondit të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit;
- Nxitjen e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mirëqeverisjes së aseteve të fondit të pensionit;
- Licencimin dhe mbikëqyrjen e shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe planit të pensionit profesional, të depozitarit të aseteve të fondeve të pensionit dhe të gjitha çështjeve të lidhura me to.

Në zbatim të metodologjisë mbikëqyrëse me bazë rrezikun, gjatë vitit 2019 u kryen inspektime në vend pranë njëres prej njësisve të depozitarëve të fondeve të pensionit vullnetar si dhe pranë njëres prej shoqërive administruese të këtyre fondeve. Objektivi i këtyre inspektimeve ishte vlerësimi i nivelit të rreziqeve mbështetur në parimet me të cilat duhet të përputhet aktiviteti i tyre, verifikimi i zbatimit të bazës ligjore në fuqi gjatë ndjekjes së procedurave operacionale në lidhje me fondet si dhe respektimi i kuadrit ligjor mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe masat kundër financimit të terrorizmit. Këto parime janë pjesë e zbatimit të metodologjisë së re mbikëqyrëse për fondet e pensioneve vullnetare, asaj me bazë rreziku, e cila u hartua dhe u miratua në vitin 2016. Nëpërmjet kësaj metodologjie evidentohen rreziqet më të mëdha që prekin këtë treg dhe njëkohësisht strategjitë që duhen ndjekur për zbatimin e tyre në një nivel të pranueshëm.

⁴ Në datë 02.02.2018, për fondin Credins Premium, shërbimi i depozitarit është transferuar nga First Investment Bank sh.a. në American Bank of Investments sh.a.

“Premium” investment fund, approved by AFSA Board Decision No. 86, dated 30.05.2016. For this company, the depository function is performed by Tirana Bank and First Investment Bank⁴.

2. Voluntary private pension market supervision

The supervision of the voluntary private pensions market is exercised by AFSA pursuant to Law No. 9572, dated 03.07.2006, “On the Financial Supervisory Authority”, as amended by Law 54/2014, and Law 10197, dated 10.12.2009, “On Voluntary Pension Funds”, as well as their respective by-laws. The purpose of the Law on Voluntary Pension Funds is to establish the necessary standards for the:

- Effective management of voluntary pension funds, through diversification of investments, with the aim of increasing the contributions made to the pension fund;
- Supervision of the voluntary pension fund business with defined contributions, in order to ensure the protection of the pension fund members;
- Promotion of sustainability, security and good governance of the pension fund assets;
- Licensing and supervision of the pension fund management company and the professional pension plan, the depository of the pension fund assets and all related matters.

In the framework of the risk-based supervisory methodology, during 2019, on-site inspections were carried out at one of the depository units of the voluntary pension funds and at one of these funds’ management companies. These inspections aimed at assessing the level of risks based on the principles their activity shall comply with, verification of the implementation of the legal basis in force during the follow-up of operational procedures regarding funds and compliance with the legal framework on money laundering and measures against terrorism financing prevention. These principles are an integral part of the implementation of the new supervisory methodology for voluntary pension funds, risk-based supervision which was drafted and adopted in 2016. This methodology identifies the greatest risks affecting this market and simultaneously, the strategies to be followed for mitigating such risks to an acceptable level.

⁴ On 02.02.2018, the depository service of Credins Premium fund was transferred from First Investment Bank sh.a. to the American Bank of Investments sh.a.

Metodologjia me bazë rrezikun, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për gjykimin e vlerësimit të rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit, i cili ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2016 me miratimin e metodologjisë së re mbikëqyrëse.

Gjatë mbledhjeve të Komitetit të Rrezikut në vitin 2019 janë prezantuar matricat e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur në sistem dhe u dakordësua vlerësimi i këtyre rreziqeve, duke identifikuar rreziqet që kërkojnë ndërhyrje më të shpejtë në sistem. Kështu, si rreziku më i madh në kushtet e Shqipërisë u identifikua rritja e pjesëmarrjes së kontribuesve në sistem, gjë që ka lidhje edhe me rritjen e besueshmërisë në sistem. Komiteti i Rrezikut, duke pasur si objektiv zbutjen e rreziqeve, miraton planin e mbikëqyrjes për një periudhë afatmesme për tregun e fondeve të pensionit.

3. Treguesit teknikë e financiarë të tregut të fondeve të pensioneve vullnetare

Tregu i pensioneve private vullnetare shfaqet më modest në krahasim me dy tregjet e tjera financiare jobankare nën mbikëqyrjen e Autoritetit. Megjithatë, ky treg ka shfaqur një dinamikë më të lartë rritjeje, veçanërisht në lidhje me numrin e anëtarëve i cili u rrit me 11.76% në krahasim me vitin 2018.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.12.2019 tregon një total të aktiveve neto prej 2,910 milionë lekë me një rritje prej 27.14% krahasuar me fundin e vitit 2018.

Në 31.12.2019 investimet e tregut të fondeve të pensionit vullnetar janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Vlera e investimeve të këtij tregu në 31.12.2019 është 2,770 milionë lekë duke zënë një peshë prej 94.84% ndaj totalit të aktiveve të tregut të fondeve të pensionit. Krahasuar me 31.12.2018 këto investime janë rritur me 25.37%. Gjatë vitit 2019, investimet e tregut të fondeve të pensioneve përbëhen nga Obligacione thesari të Republikës së Shqipërisë me afat maturimi 5, 7 dhe 10 vjeçar. Në total tregu, investimet në Obligacione të Qeverisë së R.Sh. me afat maturimi 10 vjeçar janë ato që zënë peshën më të madhe dhe përbëjnë 61.30% të totalit të investimeve të këtij tregu.

Shoqëritë administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen Invest sh.a., Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. dhe Credins Invest sh.a., e publikojnë dhe e përditësojnë vlerën e kuotës së pensionit duke zbatuar bazën ligjore në fuqi.

With a view to developing a sound process for assessing risk, the risk-based methodology included the establishment of the Pension Funds Risk Committee, which started its activity in 2016 with the adoption of the new Supervisory Methodology.

During the 2019 Risk Committee meetings, the system's inherent and residual risk matrices were presented, whereby it was agreed to conduct an assessment of these risks, thus identifying risks requiring faster system interventions. Therefore, the greatest risk identified in Albania case was the increase of the participation of contributors in the system, which is also related to the increase of credibility in the system. The Risk Committee, aiming at mitigating risks, adopted a medium-term supervision plan for the pension funds market.

3. Technical and financial indicators of the voluntary pension funds

The voluntary private pension market appears more modest compared to the other two non-bank financial markets under AFSA supervision. However, this market displayed higher growth dynamics, especially with regard to the number of members, which increased by 11.76% compared to 2018.

The private voluntary pensions fund market data analysis, at the end of 2019, indicates for a total in net assets of ALL 2.910 million with an increase of 27.14% compared to end of 2018.

As of 31.12.2019, the investments of the Voluntary Pension Funds market are in line with the applicable laws. The investment value of this market, as of 31.12.2019, is ALL 2.770 million, accounting for a share of 94.84% of the total assets of the pension fund market. Compared to 31.12.2018, these investments have increased by 25.37%. During 2019, investments in the Pension Fund Market consisted of Treasury Bonds of the Republic of Albania, with a maturity term of 3, 5, 7 and 10 years. In the total market, investments in Government Securities of the Republic of Albania, of 7 and 10 years maturity term, are the ones occupying the largest share and accounting for 32.86% and 61.30% of the total assets of this market respectively.

The Raiffeisen Invest sh.a, Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a and Credins Invest sh.a pension fund management companies publish and update the value of the pension shares, in accordance with the applicable laws.



IV. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Investimeve

1. Struktura e tregut të fondeve të investimeve

Deri në 31.12.2019 në treg kanë operuar pesë fonde investimi, të cilët janë:

- Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 180, datë 13.12.2011;
- Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 135, datë 26.09.2012;
- Fondi i Investimit Credins Premium, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 86, datë 30.05.2016;
- Fondi i Investimit WVP Top Invest, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 14, datë 31.01.2018; dhe
- Fondi i Investimit Raiffeisen Vizion, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 143, datë 30.07.2018.

Fondet e Investimit Raiffeisen Prestigj, Raiffeisen Invest Euro dhe Raiffeisen Vizion administrohen nga SHAFP dhe SIK Raiffeisen Invest sh.a., Fondi i Investimit Credins Premium administrohet nga SHAFP dhe SIK Credins Invest sh.a. dhe fondi WVP Top Invest administrohet nga SIK WVP Fund Management Tirana sh.a.

Në nëntor të vitit 2019 është licencuar shoqëria administruese Albsig Invest sh.a. e cila do të kryejë veprimtarinë e administrimit si për fondet e investimit, ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar. Fondi i investimit që administrohet nga shoqëria Albsig Invest sh.a. është licencuar në dhjetor 2019 dhe ka nisur aktivitetin në shkurt 2020.

Për fondet e investimit të administruar nga shoqëria Raiffeisen Invest sh.a. dhe për fondin e investimit të administruar nga shoqëria WVP Fund Management Tirana sh.a. funksionin e depozitarit e kryen Banka e Parë e Investimeve, e cila është licencuar nga AMF për të kryer funksionin e depozitarit me Vendimin e Bordit nr. 80, datë 30.08.2010, ndërkohë që për fondin e investimit të administruar nga shoqëria Credins Invest sh.a. funksionin e depozitarit e kryen Banka Amerikane e Investimeve sh.a. e cila është licencuar nga AMF për të kryer funksionin e depozitarit me Vendimin e Bordit nr. 5, datë 03.07.2017.

IV. Report on the Financial Position of the Investment Fund Market

1. Investment funds market structure

By 31.12.2019, the following five investment funds have been operating in the market:

- *Raiffeisen Prestige Investment Fund, approved by AFSA Board Decision No. 180, dated 13.12.2011;*
- *Raiffeisen Invest Euro Investment Fund, approved by AFSA Board Decision No. 135, dated 26.09.2012;*
- *Credins Premium Investment Fund approved by AFSA Board Decision No. 86, dated 30.05.2016;*
- *WVP Top Invest Investment Fund, approved by AFSA Board Decision No. 14, dated 31.01.2018; and*
- *Raiffeisen Vision Investment Fund, approved by AFSA Board Decision No. 143, dated 30.07.2018.*

Raiffeisen Prestige, Raiffeisen Invest Euro and Raiffeisen Vision Investment Funds are managed by the PFMC and CIU Raiffeisen Invest sh.a., Credins Premium Investment Fund is managed by the PFMC and CIU Credins Invest sh.a., and WVP Top Invest Investment Fund is managed by CIU WVP Fund Management Tirana sh.a.

In November 2019, the management company Albsig Invest sh.a., which will carry out the administration of both investment funds and voluntary pension funds, was licensed. The investment fund administered by Albsig Invest sh.a. was licensed in December 2019 and started operating in February 2020.

For the investment funds managed by Raiffeisen Invest sh.a. and for the investment fund managed by WVP Fund Management Tirana sh.a., the depositary role was carried out by the First Investment Bank, which is licensed by AFSA to perform the depositary function by Board Decision No. 80, dated 30.08.2010, while for the investment fund managed by Credins Invest sh.a. the depositary role was carried out by American Bank of Investments sh.a., which is licensed by AFSA to perform the depositary function by Board Decision No. 5, dated 03.07.2017.

2. Mbiqëqyrja e tregut të fondeve të investimeve

Mbiqëqyrja e tregut të fondeve të investimit gjatë vitit 2019 është ushtruar nga AMF mbështetur në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare", i ndryshuar, Ligjin 10198 datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

AMF, për të përballuar sfidat e këtij tregu, ka punuar gjatë vitit 2019 për përmirësimin e bazës ligjore e rregullatore për fondet e investimeve. Kështu, në 20.06.2020 hyri në fuqi Ligji i ri "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive".

AMF po përballon aktualisht me sfidat e forcimit të kapaciteteve për mbiqëqyrjen dhe rregullimin e industrisë së re të fondeve të investimit, me qëllim përballimin në kohë të rreziqeve dhe nxitjes së zhvillimit të tregut të titujve, duke u fokusuar në tregun e obligacioneve, me qëllim zbutjen e rrezikut të investimeve dhe përmirësimin e procesit të shpërndarjes së kapitalit në tregun vendas.

